



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Nr. 196 Prot

Tiranë, më 27/5/2022

URDHËR I BRENDSHËM

Bazuar në manual për "Përcaktimin e rregullave, kritereve dhe procedurave për shpalljen e pozicioneve të vendeve vakante në administratën e AMVV-së, nr. 94/1 datë 09.03.2021, ndryshuar, i cili është hartuar sipas rregullores së brendshme të AMVV –së, shpallim vendin vakant si më poshtë:

- **Pozicioni e vendeve të lira të punës;**

1. Specialist në sektorin e Zhvillimit 1 (një) vend, kategoria e pages IV-a.

- **Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës;**

1. Për pozicionin specialist në sektorin e Zhvillimit, kandidati duhet të plotësojë këto kritere

- a) Të jetë shtetas Shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- g) Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës;
- h) Të zotëroj gjuhën Agleze të folur dhe të shkruar;
- i) Të ketë mbaruar arsimin e lartë Master Profesional ose Shkencor;
- j) Të ketë jo më pak 1 vjet eksperiencë në fushën e pushtetit vendor.

- **Arsimi:** Të ketë mbaruar arsimin e lartë Master Profesional ose Shkencor; në shkencat juridike, sociale apo ekonomike

- **Listën e dokumentave që duhet të paraqesin;**

Fotokopje e të gjithë dokumentave që vërtetojnë që ju përmbushni kriteret e kërkuara për pozicionin vakant që konkuroni:

- 1) Kërkesë për punësim;
- 2) Jetëshkrim;
- 3) Fotokopje të diplomës;
- 4) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 5) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 6) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 7) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

- **Afatin dhe vendin e dorëzimit të dokumentave;**

Afati i fundit i dorëzimit të dokumentave është data 06.06 2022 ora 16.00

- **Vëndi i dorëzimit të dokumentave është protokoli i AMVV-re ose me postë.**

- **Procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes;**

Konkurimi përfshin dy faza:

- a) Faza e parë konsiston në verifikimin nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe/ose të veçanta në shpalljen për konkurim. Vetëm kandidatët që plotësojnë këto kërkesa, i nënshtrohen fazës të mëtejshme të konkurimit
- b) Faza e dytë është faza e intervistimit të kandidatëve të kualifikuar, e cila synon të evidentojë formimin profesional të kandidatëve dhe përzgjedhjen e kandidatit me rezultatet më të larta.
- c) Verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati duhet të realizohet brenda 3 ditëve punë nga njësia e burimeve njëreze dhe të procedohet me njoftimin për kandidatët, të cilët nuk janë kualifikuar duke përcaktuar edhe arësyet.
- d) Afati i ankimit dhe shqyrtimit të ankimit të kandidatëve, të cilët nuk janë kualifikuar për të vazhduar fazën e intervistës është 2 ditë nga marrja e njoftimit për s'kualifikim. Në këtë rast njësia e burimeve njëreze të institucionit, në rast se nuk ka ankesa shpall listën e kandidatëve për të vijuar me intervistën brenda 5 ditëve pune. Afati 5 ditor është gjithashtu afati brenda të cilës duhet të shqyrtohen ankesat nga kandidatët e s'kualifikuar, si dhe të kthehet përgjigje.
- e) Caktimi i datës dhe vendit të intervistës bëhet brenda 2 ditëve pas kalimit 5 ditor, të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni.

- f) Totali i pikëve të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 50 pikë për jetëshkrimin/eksperiencën/pastërtinë e figurës dhe 50 pikë për intervistën me gojë.
- g) Shpallja e fituesve realizohet brenda 5 ditëve punë nga përfundimi i intervistës.
- h) Ankimimi dhe shqyrtimi i ankesave për rezultatet finale bëhet brenda 5 ditëve punë.
- i) Fitues shpallet kandidati që ka fituar pikët më të larta.
- j) Pas shpalljes së fituesit lidhet kontrata e punës.

- **Datën, kohën dhe vendin ku do të kryhet intervista.**

Intervista do të kryhet në ambjentet e AMVV-re, sipas njoftimit të së cilit, që do ti dërgohet në adresën e emailit të së cilit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Enea Hoti

